

Buxheti i vitit 2008 eshte hartuar duke u mbeshtetur ne ligjin Nr. 8652 date 31.07.2000 «Per organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore » , te ligjit Nr.7776 date 22.12.1993 « Per buxhetin lokal », ligjin Nr.8379 date 29.07.1998 « Per hartimin dhe zbatimin e buxhetit te shtetit te Republikes se Shqiperise », ligjin Nr.9836 date 26.11.2007 « Per buxhetin e shtetit te vitit 2008 » si dhe ne Udhezimit Nr.4 date 17.01.2008 « Per zbatimin e buxhetit te shtetit per vitin 2008 » .

Disa nga parimet e hartimit te buxhetit te vitit 2008 jane :

= I balancuar dhe transparent

Buxheti i vitit 2008 paraqitet i balancuar (te ardhurat = shpenzimet).

= I besueshem

Buxheti i vitit 2008 planifikohet ne baze te burimeve te mundshme dhe te realizueshme te te ardhurave nga buxheti i shtetit dhe nga te ardhurat e gjeneruara lokale . Kjo mundeson realizimin e shpenzimeve ne kohe sipas nje programi te parashikuar te gjenerimit te te ardhurave dhe mundesise per likuiditete ne cdo kohe te lindjes se shpenzimit.

= Eficienca dhe efektiviteti

Buxheti i vitit 2008 eshte hartuar duke kryer shperndarjen me te mire te burimeve te te ardhurave me nje tendence ne rritje drejt shpenzimeve kapitale dhe atyre te mirembajtjes se sherbimeve, duke balancuar se pari nevojat afat-shkurtera te komunitetit me strategjite afat-mesme dhe vizionin afat-gjate per zhvillimin e qytetit .

= Barazi ne shperndarje

Buxheti i vitit 2008 siguron qe burimet e te ardhurave te shperndahen ne menyre te drejte ndaj te gjithe zonave te qytetit duke ekualizuar shperndarjen pavaresisht kontributit te te ardhurave qe komunitetet kane sipas zonave. Kjo rishperndarje ka bere qe zonat e periferise te perfitojne investime dhe sherbime ne nivele te krahasueshme me ato kontribuese ne buxhetin e Bashkise .Konkretisht ne paketen fiskale te miratuar ne fund te vitit shume nga taksat dhe tarifat jane nen nivelin tregues se takses apo tarifes .

Te tjera mbi buxhetin e vitit 2008

Edhe kete vit vazhdon kalimi i fondeve per investimet publike lokale nga autoriteti i plote i disa ministrive tek Parlamenti, qe i shperndan fondet e investimeve sipas nje formule me kritere qe tentojne te jene objektive. Per vitin 2008 Bashkia ka cuar disa projekte nga te cilat mendojme te perzgjidhen duke bere te mundur perfitimin e grantit konkurrense per financimin e tyre. Per vitin 2007 Bashkia perfitoi kater projekte nga grantet konkurrense .

VECORITE E PAKETES AKTUALE FISKALE

1- Transferta e pakushtezuar

Transferta e pakushtezuar ose granti shperndahet bazuar ne nje formule, formule e cila sanksionohet cdo vit ne ligjin „Per buxhetin e shtetit“.Formula per shperndarjen e transferes se pakushtezuar , aplikuar per here te pare ne vitin 2002 dhe pjese e ligjit „Per Buxhetin e shtetit“, qe nga momenti i miratimit te saj dhe deri tani ka pesuar ndryshime

te herpashershme. Ne mbeshtetje te Ligjit Organik te Pushtetit Vendor transfertat e pakushtezuara nga buxheti i shtetit jane per perballimin e shpenzimeve te funksioneve te perbashketa si mirembajtja dhe funksionimi i arsimit parashkollor dhe parauniversitar, rendi publik dhe mbrojtja civile, kujdesi social etj. si dhe garantimi i funksioneve te veta . Totali i transfertes se pakushtezuar per vitin 2008 ka pesuar nje rritje prej 6.3 % ose 8 milion leke .

2- Transferta e kushtezuar

Transferta e kushtezuar jepet nga buxheti i shtetit kryesisht per perkrahjen sociale ,subvencionet per shpenzimet e varrimit ,funksionet e deleguara si gjendja civile dhe sekretari i deputetit , kompesimin e bursave dhe ½ bursave te nxenesve konviktore dhe rruge urbane. Ecuria e tyre nuk varet nga Bashkia por nga kriteret e perdorura nga Ministrite e linjes te cilat ndryshojne nga viti ne vit .

3-Parashikimi i te ardhurave per vitin 2008

Parashikimi i te ardhurave lokale eshte bere duke u bazuar ne vleresimin e bazes se te gjitha burimeve te te ardhurave si dhe ne nivelet e miratuara nga Keshilli Bashkiak me VKB Nr. 115 date 11.12.2007. Ne vleresimin e burimeve te te ardhurave dhe propozimin e tyre per vitin 2008 vemendje eshte perqendruar ne sa vijon:

- Administrimin me te mire me qellim uljen e evazionit fiskal duke u perqendruar ne evidentimin e subjekteve te parregjistruara dhe arketimin e debitoreve ne vite.
- Tendencen e rritjes dhe zhvillimit te bizneseve.
- Krijimin e nje baze te sakte dhe te qendrueshme te dhenash per te gjitha fazat e administrimit te tatimeve.
- Rakordimet analitike persa i takon Taksave te mbledhura nga agjentet tatimore (Taksen e rregjistrimit te mjeteve dhe taksen e transaksioneve te Pasurise se Paluajtshme).

Ne teresi te ardhurat e Bashkise per vitin 2008 nga Taksat dhe Tarifate Vendore kane nje rritje krahasuar me realizimin e tyre per vitin 2007 prej rreth 64.8 % . Te ardhurat nga Taksat dhe Tarifate Vendore per vitin 2008 , pa perfshire fondet e mbartura parashikohen ne shumen prej 253.170 mije leke .

SHPENZIMET

Funksionet ekskluzive te Bashkise se Lushnjes jane ato te ofrimit te sherbimeve publike, nepermjet vendim-marrjes se plote, duke perfshire administrimin, ofrimin e sherbimeve, investimet dhe rregullimet.

Funksionet ekskluzive te Bashkise se Lushnjes financohen nga *te ardhurat e veta* , duke perfshire taksat lokale, tarifate per sherbime, si dhe *transfertat e pakushtezuara* te cilat financojne sherbimet normale publike vendore qe lidhen me infrastrukturen si rruget lokale, trotualet dhe sheshet, kanalizimet, administrimin e mbetjeve urbane dhe te ngurta (pastrimin e rrugeve dhe mbledhjen e mbeturinave), ndricimi i rrugeve dhe dekori i qytetit , mirembajtja sipërfaqjes se gjelber dhe e hapësirave publike.

Tendencat kryesore te shpenzimeve jane :

- Rritja e shpenzimeve kapitale te cilat zene rreth 42% te buxhetit te Bashkise Ristrukturimin, ky kryesisht ne Ndermarjen e Mirembajtjes se pasurise Publike pasi ketu perfshihen sherbimi i mirembajtjes rruge-trotuare dhe nje pjese e sherbimit te pastrimit dhe gjelberimit qe nuk perfshihen ne
- kontraten me firmat sipermarese te sherbimeve respektive, keto kalojne si funksione shtese te Ndermarjes per vitin 2008.
- Mbajtja e pandryshuar e nivelit te pagave per te gjithë sistemin. Fondi i pagave paraqitet ne rritje si pasoje e rritjes se pages qe u be ne shtator te v. 2007 per te zbutur efektin e vendosjes se takses se sheshte .Bashkalidhur jane pasqyrat analitike sipas struktures buxhetore te te ardhurave dhe shpenzimeve